



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 15 janar 2014, në mbledhjen e II-të (dytë) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 10. 00' dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Vehbi Rushiti, anëtari më i vjetër i Kuvendit.

U vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri

2. Miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës më 23 dhjetor 2013.

Ekstrakti i procesverbalit u miratuan njëzëri.

3. Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës së pari ju përkujtoj se duhet të ngritët Komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit, dhe shtoj, lidhur me këtë propozoj që ky Komision të përbëhet prej tre anëtarëve dhe atë nga subjektet politike LDK, PDK dhe AAK – LDD.

Pas votimit u konstatua se propozimi i kryesuesit të mbledhjes u miratua njëzëri.

➤ Ngritja e Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të votimit

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, në vazhdim i ftoi përfaqësuesit e subjekteve politike LDK, PDK dhe AAK – LDD, të propozojnë kandidatët e tyre.

z. Fidan Rekalju, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, për anëtar të Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të votimit e propozon z. Afrim Shabanin.

z. Naim Çunaku, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK, për anëtar të Komisionit për mbikëqyrjen e procesit të votimit e propozon z. Kadri Avdiun.

z. Mirsad Kamerolli, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga subjekti AAK – LDD, e propozoj z. Lutfi Rexhepin.

Pas votimit u konstatua se Komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, njëzëri u ngrit në këtë përbërje:

z. Afrim Shabani

z. Kadri Avdiu

z. Lutfi Rexhepi

➤ **Propozimi i kandidatëve**

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, theksoi, ju përkujtoj se propozimet e kandidatëve për kryesues të Kuvendit mund t'i bëjnë:

Subjektet politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit, ndonjë Grup i këshilltarëve dhe këshilltarët në mënyrë individuale.

z. Agim Kikaj, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, për kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës për këtë mandat propozoj z. Mehmet Gashin dhe shtoi, për ata të cilët nuk janë në dijeni për personalitetin e personit në fjalë unë si arsyetim do t'i them vetëm disa fjalë z. Mehmet Gashi si zyrtar dhe si personalitet gjithë karrierën e tij të gjatë ka provuar përkushtim të ligjshmërisë dhe raporte ndërnjerëzore dhe korrektesë të kënaqshme. Në postet publike qoftë në Administratë qoftë në ato politike ka promovuar integritet profesional dhe moral, prandaj për këto dhe shumë arsye të tjera ne mendojmë se i propozuari i cekur është i denjë që për këtë mandat të kryesoj Kuvendin e Komunës së Podujevës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për kryesues të Kuvendit të Komunës e propozon z. Naim Çunakun dhe shtoi ne mendojmë se z. Naim Çunaku në aspektin profesional por edhe në aspektin e përvojës së tij në legjislaturë për vite me radhë i plotëson kushtet që të kryesoj Kuvendin e Komunës.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik AAK – LDD, për kryesues të Kuvendit të Komunës e propozon, z. Mirsad Kamerollin, unë për dallim nga dy kolegët parafolës nuk do të jap shpjegime apo arsyetime ngase për personalitetin e z. Mirsad Kamerollit jam i bindur se jeni në dijeni të gjithë.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik LVV kemi vendosur që të përmbahemi me rastin e votimit për kryesues të Kuvendit të Komunës ashtu siç kemi vendosur të përmbahemi edhe për propozimin për kryesues të Kuvendit, ne si Grup i këshilltarëve, ne kemi vendosur t'i ndërmarrim këto veprime ngase konsiderojmë se për këtë ka shumë arsye.

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, nënvizoi, në bazë të propozimeve që u bënë nga parafolësit konstatoj se kandidat për kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës janë:

z. Mehmet Gashi,

z. Naim Çunaku, dhe

z. Mirsad Kamerolli

Në vazhdim, kryesuesi i mbledhjes, e ftoi Komisionin për mbikëqyrjen e procesit të votimit që në bashkëpunim me Shërbimin për punë të Kuvendit të përgatisin

fletëvotimet, me emrat dhe mbiemrat e kandidatëve në mënyrë që të fillohet votimi me vota të fshehta në pajtim me legjislacionin në fuqi.

➤ **Procesi i votimit**

Procesi i votimit, në raundin e parë, filloi duke u thirrur këshilltarët e Kuvendit emër për emër të cilët u nënshkruan në listën e votimit, morën fletëvotimin e vulosur dhe një nga një votuan në kabinën e votimit dhe votën e hedhën në kutin përkatëse. Pas përfundimit të votimit u paraqit:

➤ **Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit**

Në emër të Komisionit z. Lutfi Rexhepi, raportoi për procesin e votimit me konstatim se procesi i votimit ka përfunduar në mënyrë të rregullt sipas procedurave të parapara me dispozita ligjore dhe se kanë votuar të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përkatësisht 35 këshilltarë dhe rezultatet janë si në vijim:

z. Mehmet Gashi, ka marrë 17 vota

z. Mirsad Kamerolli, ka marrë 2 vota

z. Naim Çunaku, ka marrë 12 vota,

Ndërsa 4 fletëvotime ishin të pavlefshme.

Në vazhdim z. Lutfi Rexhepi, nënvizoi, në bazë të nenit 41.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, asnjëri nga kandidatët nuk ka arritur të marrë numrin e mjaftueshëm të votave e që është më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur, për t'u zgjedhur kryesues i Kuvendit të Komunës, bazuar në këtë Komisioni konstaton se votimi duhet të vazhdoj me raundin e dytë, ashtu siç parashihet me nenin 41.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe se në votim të dytë shkojnë dy kandidatët të cilët kanë marrë numër më të madh të votave në raundin e parë, përkatësisht:

z. Mehmet Gashi, dhe

z. Naim Çunaku

➤ **Procesi i votimit, raundi i dytë**

z. Lutfi Rexhepi, në emër të Komisionit për mbikëqyrjen e votimit, i përkujtoi këshilltarët e Kuvendit se procedura e votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit do të jetë e njëjtë me procedurën e votimit në raundin e parë përveçse fletëvotimet do të jenë me ngjyrë të kuqe, për dallim nga raundi i parë ku fletëvotimet ishin me ngjyrë të bardhë. Pas përfundimit të votimit u paraqit:

➤ **Raporti i Komisionit për rezultatet e votimit në raundin e dytë**

Në emër të Komisionit z. Lutfi Rexhepi, theksoi, ju njoftojmë se votuan të gjithë këshilltarët e Kuvendit, gjithsej 35 këshilltarë, dhe se procesi i votimit ka përfunduar në mënyrë të rregullt, sipas procedurave të parapara, dhe rezultatet e votimit janë :

z. Mehmet Gashi, ka marrë 18 vota, ndërsa

z. Naim Çunaku, ka marrë 13 vota

4 fletëvotime janë të pavlefshme.

Në bazë të kësaj Komisioni konstatoj se duke u bazuar në nenin 41.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku në raundin e dytë të votimit me shumicën e votave përkatësisht 18 vota nga gjithsej 35 vota të këshilltarëve të Kuvendit, kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës është zgjedhur z. Mehmet Gashi.

z. Vehbi Rushiti, kryesues i mbledhjes, në vazhdim ftoi z. Mehmet Gashin kryesues i sapo zgjedhur i Kuvendit për një fjalë rasti dhe njëkohësisht të merr kryesimin e mbledhjes për të vazhduar me pikat tjera të rendit të ditës.

z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, theksoi, të nderuar këshilltarë të Kuvendit të Komunës, i nderuar Kryetar i Komunës, përfaqësues i OSBE-së, përfaqësues të institucioneve dhe mediave, mysafirë të nderuar, zonja dhe zotërinj, ju falënderoj thellësisht për besimin e dhënë për kryesues të Kuvendit të Komunës.

Jam i bindur se gjatë mandatit tonë këtë funksion do ta ushtroj në pajtim të plotë me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e punës të Kuvendit dhe dispozitat tjera ligjore që rregullojnë funksionimin e Kuvendit të Komunës.

Të nderuar kolegë, këshilltarë të Kuvendit, shpresoj se gjatë mandatit tonë do të arsyetojmë besimin dhe përgjegjësin e marrë nga qytetarët.

Gjithashtu unë si kryesues i Kuvendit do të angazhohem për krijimin e një klime të mirë dhe të barabartë për të gjithë anëtarët e Kuvendit në mënyrë që funksionin e këshilltarit ta ushtroni sa më suksesshëm. Shprehi bindjen time të thellë se do të kem përkrahjen tuaj të plotë, bashkëpunimin dhe përkushtimin e të gjithë neve që bashkërisht ta arsyetojmë votën e qytetarit dhe t'i realizojmë nevojat dhe kërkesat e tyre.

4. Propozimi i vendimit për dhënien në përdorim të llaptopëve këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës

z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, theksoi, jam i mendimit se pajisja me llaptopë është në interes të të gjithë këshilltarëve në funksion të lehtësimit dhe efikasitetit të punës suaj, pajisja me llaptopë bëhet në bazë të një vendimi të miratuar më parë në Kuvendin e Komunës, ndërsa mënyra e shfrytëzimit dhe përdorimit të llaptopëve është e përshkruar në propozimin e këtij vendimi.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, përshëndetje zotëri Kryesues i Kuvendit, fillimisht ju uroj punë të mbarë në funksionin e kryesuesit të Kuvendit dhe shtoi, jam i mendimit se propozimi i këtij vendimi është i qëlluar meqë pajisja e këshilltarëve me llaptopë është e nevojshme ngase puna e këshilltarëve dhe funksionimi i Kuvendit në përgjithësi do të jetë më efikase, meqë pa shfrytëzimin e Teknologjisë informative puna dhe angazhimi nuk mund të mendohet as tani e as në të ardhmen. Mirëpo ne jemi në dijeni se teknologjia çdo ditë e më shumë është duke u zhvilluar dhe avancuar, andaj ashtu siç parashihet në këtë propozim vendim që llaptopët t'i kthehen prapë pas katër viteve Komunës unë mendoj se është demode ngase pas katër viteve këta llaptopë mund të dalin nga përdorimi, andaj mua më duket e pakuptimtë që llaptopët t'i kthehen prapë Komunës pas katër viteve duke pasur parasysh llaptopët do të përdoren, por fundja edhe nëse nuk përdoren fare, pas katër viteve prapë do të mbeten demode si pronë e Komunës. Pra në këtë kontekst propozoj të shikohet mundësia nëse mund të gjendet ndonjë variant që do të mund të ndryshohej ky propozim vendim në mënyrë që llaptopët të mbeten pronë e këshilltarëve edhe pas katër viteve duke u klasifikuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

z. Naim Çunaku, theksoi, përshëndetje zotëri Kryesues dhe urime për zgjedhjen e juaj në pozitën e kryesuesit të Kuvendit dhe ju dëshiroj punë të mbarë, dhe shtoi, dëshiroj t'i njoftoj këshilltarët e rinj në përbërjen e re të Kuvendit se ky Kuvend para dy viteve, në hap me Komunat tjera të cilat në mandatin e kaluar e kanë marr vendimin për pajisje të këshilltarëve me llaptopë dhe tani është mirë që edhe Komuna e jonë po e ekzekuton vendimin përkatës të Kuvendit.

Unë, në një formë e mbështesë propozimin të cilin e paraqiti z. Lutfi Rexhepi ngase plotësisht është e qëndrueshme vërejtja se duke u bazuar në zhvillimin e hovshëm të Teknologjisë informative, llaptopët aktual pas katër viteve pothuajse do të dalin jashtë funksionit dhe mbi këtë bazë propozoj të shqyrtohen mundësitë që të modifikohet neni i cili parasheh kthimin e llaptopëve.

Përndryshe do të dëshiroja që në të ardhmen këshilltarët e këtij Kuvendi të pajisen edhe me aparate të tjera teknologjike dhe të jenë në hapë kolegët e komunave të tjera, në mënyrë që Komuna e Podujevës të mos mbetet e fundit.

z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë unë jam i mendimit se ky propozim vendim është në përputhshmëri të plotë me ligjin, kështu kanë vepruar edhe Komunat tjera, mirëpo në të ardhmen ne do të shikojmë nëse ka ndonjë mundësi për modifikim të këtij vendimi, gjithashtu ju njoftoj se vendimi fillon të ekzekutohet nga java e ardhshme.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i këtij vendimi.

5. Të Ndryshme

z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne nuk kemi paraparë asnjë temë për të diskutuar, mirëpo ju njoftoj se në mbledhjen e radhës të Kuvendit do të përqipemi të bëjmë orarin e mbledhjeve të Kuvendit dhe strukturën e trupave të Kuvendit, gjithashtu do të kishte qenë mirë që partitë politike të përfaqësuara në këtë Kuvend t'i propozojnë Shefat e grupeve të këshilltarëve, propozimet mundësisht të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në Zyrën e kryesuesit të Kuvendit ose në Zyrën e shërbimit për punë të Kuvendit.

z. Naim Çunaku, theksoi, lidhur me çështjen të cilën e shtroi kryesuesi i Kuvendit, ju njoftoj se PDK ka marrë vendim që në Kuvendin e Komunës së Podujevës z. Kadri Avdiu, të jetë Shef i Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës

Mbledhja përfundoi në orën 11.35'

Procesverbalin e mbajtën

Faik Gashi

Enis Sheholli

Nr. 01-006-6661

Podujevë,

15 janar 2014

Kryesuesi i Kuvendit

Mehmet Gashi